

Tiranë, më 21.08.2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mbikëqyrje punimesh për nevoja të OSSH sh.a. (2026), ndarë në 7 Lote”

- **Loti 1** “Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim 2026, për Rikonstruksionin e N.Stacionit Kinostudio 110/35/20kV, 1x40/50MVA”
- **Loti 2** “Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim 2026, për Drejtorinë Rajonale Tiranë të OSSH sh.a (pjesa II)”
- **Loti 3** “Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim 2026, për Ndërtimin e linjës 35kV, 1x120mm², Bogë - Theth”
- **Loti 4** “Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim 2026, për Instalimin e sistemit të matjes intiligjente në konsumatorët fundorë, në sistemin e matjes të bilancit të energjisë në kabinat elektrikeTM-TU, dhe integrimi i tyre në platformën e matjes të OSSH sh.a”
- **Loti 5** “Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim 2026, për Ndërtimin e linjës 35kV Kavajë - Rrogozhinë, shtylla me 2 qarqe, (1x240mm²)”
- **Loti 6** “Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim 2026, për Drejtorinë Rajonale Fier të OSSH sh.a (pjesa II)”
- **Loti 7** “Mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim 2026, për Drejtorinë e Tensionit të Lartë të OSSH sh.a (pjesa II)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Mbikëqyrja e punës së ndërtimit 71247000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 26,326,167.23 (njëzet e gjashtë milion e treqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë njëzet e tre) Lekë pa TVSH ose 284,514.94 (dyqind e

tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e katërmëdhjetë pikë nëntëdhjetë e katër) Euro pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor **DREJTORIA RAJONALE TIRANË E OSSH SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në zbatim të pikës 2 të Nenit 56 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikës 3 të Nenit 24 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor do të publikojë njoftimin e kontratës dhe në gjuhën Angleze.

Në zbatim të pikës 2 Neni 12 i VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor ka konvertuar vlerën limit të kontratës në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë **data 21.08.2026, ora 12:09:48**

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)¹ **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

- **Çmimi** pikët **50** (pesëdhjetë)

- **Propozimi teknik** pikët **50** (pesëdhjetë)

Kriteret e vlerësimit për propozimin teknik:

(I) Përvoja per Punë të Ngjashme të operatorit ekonomik [5 pikë]

Nënkriteret

I/a. Përvoja për shërbime të ngjashme 4 pikë

Operatorët ekonomikë do të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

I/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 1 pikë

Operatorët ekonomikë do të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

(II) Metodologjia e Propozuar [15 pikë]

Nënkriteret

II/a. Përqasja teknike dhe metodologjia

4.5 pikë

Operatori ekonomik duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesin problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojnë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegohet metodologjia që propozojnë të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës.

II/b. Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

6 pikë

Operatori ekonomik duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlikdhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

II/c. Organizimi i Stafit

4.5 pikë

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit të tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

(III) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

[30 pikë]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

III/a. Kualifikim i përgjithshëm

6 pikë

Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

III/b. Eksperienca në fushën përkatëse

24 pikë

Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor

Total Propozimi teknik

[50 pikë]

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën 10;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën 3, në vlerën e specifikuar (në masën 2% të fondit limit) për secilin lot përkatës ku operatori konkurron.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të provojë regjistrimin në regjistrin tregtar (QKB) ku të përfshihet objekti i veprimtarisë në fushën e projektimit, mbikëqyrjes apo kolaudimit të punimeve të ndërtimit/elektrike, si dhe të jetë në gjendje aktive.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe Ligjit nr. 9723, datë 07.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, për të vërtetuar statusin ligjor dhe profesional të operatorit për të ushtruar aktivitetin e kërkuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e vlerës së fondit limit** për secilin lot (ose shumatores së loteve) për të cilat konkurron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i xhiros vjetore në nivelin **40% të fondit limit** të lotit/loteve përkatëse është vendosur me qëllim **lehtësimin e kriterëve financiare dhe nxitjen e pjesëmarrjes maksimale** të shoqërive të konsulencës dhe mbikëqyrjes në garë. Ky nivel (i cili është nën kufirin maksimal të lejuar prej 100%) siguron nga njëra anë që operatorët zotërojnë kapacitete të mjaftueshme likuiditeti për të përballuar menaxhimin e kontratës, dhe nga ana tjetër eliminon barrierat ekonomike artificiale, duke mundësuar një garë më të hapur dhe ekonomike për autoritetin kontraktor.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, ku përcaktohen afatet e dorëzimit të deklaratave vjetore tatimore (vitet e fundit financiare të mbyllura zyrtarisht).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore (pasqyrat financiare), për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku përcaktohen rastet dhe kriteret e madhësisë (të ardhurat nga aktiviteti, aktivi i bilancit, numri i punonjësve) kur personat juridikë kanë detyrimin ligjor që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore përpara publikimit të tyre, si dhe Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor...", i ndryshuar.

Ky kriter garanton që shoqëria që do të marrë përsipër mbikëqyrjen ka një strukturë kapitale të shëndetshme (jo në prag falimentimi apo me risqe likuiditeti), duke siguruar vazhdimësinë e aktivitetit pa ndërprerje gjatë vitit 2026.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës), në një vlerë jo më të vogël se **20% e vlerës së fondit** limit për secilin lot (ose shumatores së loteve) për të cilat konkurren.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik: operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, objekti, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore;

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat: operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e kriterit të përvojës së ngjashme në masën minimale prej **20% të fondit limit** bëhet me qëllim eliminimin e çdo barriere artificiale dhe nxitjen e pjesëmarrjes maksimale të operatorëve ekonomikë në garë. Duke qenë se procedura është e ndarë në 11 lote dhe synon mbulimin e shërbimeve të mbikëqyrjes në të gjithë Shqipërinë, ky prag i ulët u mundëson edhe studiove të reja apo lokale inxhinierike të ofrojnë shërbimet e tyre. Kjo rrit konkurrencën efektive dhe garanton eficiencë ekonomike për autoritetin

kontraktor, pa cenuar cilësinë, pasi stafi inxhinierik gjithësesi do të vlerësohet rreptësisht në kriteret pasuese.

Për sa i përket dokumentacionit provues, kërkesa për vërtetime të entit publik dhe fatura tatimore të deklaruara është në përputhje të plotë me legjislacionin fiskal në fuqi, duke garantuar se përvoja e deklaruar është e vërtetueshme, formale dhe e pasqyruar saktë në sistemet tatimore.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për shoqëri (person juridik) për mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar me VKM nr. 943, datë 28.12.2016 *"Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar.*

Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve të zbatimit në ndërtim duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **NP-1:** Punime gjurmimi në tokë
- **NP-2:** Ndërtime civile dhe industriale
- **NP-11:** Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike
- **NP-12:** Punime të inxhinierisë së mjedisit
- **NS-1:** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **NS-8/a:** Ndërtime parafabrikat beton arme
- **NS-18:** Punime topogjeodezike

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 'Për prokurimin publik' i ndryshuar, dhe nenin 41, pika 4/a të VKM-së nr. 285/2021, i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorive është në përputhje të plotë me VKM nr. 759/2014, ndryshuar me VKM nr. 943/2016, dhe reflekton strukturën e preventivave të punimeve. Autoriteti Kontraktor ka përzgjedhur vetëm kategoritë që kanë një peshë specifike dhe volum domethënës në projekt, duke shmangur kërkimin e licencave sekondare që do të ngarkonin shoqëritë dhe do të kufizonin garën në tregun e konsulencës. Ky konfigurim licencash siguron që subjekti i përzgjedhur ka zotërim të plotë ligjor për të certifikuar të gjithë investimin.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) për secilin lot (ose shumatores së loteve) për të cilat konkurron, si më poshtë:

- **a. Drejtuesi i Mbikëqyrjes:** Individ i pajisur me licencë profesionale individuale në fuqi për mbikëqyrje punimesh në **Kategorinë N.P-11**, lëshuar nga Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën.
- **b. Mbikëqyrës i Ndërtimit:** Individ i pajisur me licencë profesionale individuale në fuqi për mbikëqyrje punimesh në **Kategoritë NP-1, NP-2, NS-1 dhe NS-8/a**, lëshuar nga Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën.
- **c. Mbikëqyrës i Mjedisit:** Individ i pajisur me licencë profesionale individuale në fuqi për mbikëqyrje punimesh në **Kategorinë NP-12** lëshuar nga Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën.
- **d. Mbikëqyrës Topograf:** Individ i pajisur me licencë profesionale individuale në fuqi për mbikëqyrje punimesh në **Kategorinë NS-18** lëshuar nga Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën.

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- **a. Përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë:** Individ i pajisur me certifikatë/dëshmi të vlefshme kualifikimi si "Person i autorizuar për sigurinë dhe shëndetin në punë", në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen në punë, i cili do të mbikëqyrë zbatimin e masave të sigurisë dhe përdorimin e mjeteve mbrojtëse (TDP/TDI) gjatë ndërhyrjeve elektrike.
- **b. Ekspert/Punonjës i Trajnuar për Ndhmën e Parë:** Individ i certifikuar/trajnuar për dhënien e ndihmës së parë mjekësore në kantier (vërtetuar me certifikatë të vlefshme trajnimi të lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar ose institucion i licencuar për trajnime të sigurisë në punë).

** Staf i kërkuar në pikën 2.3.3 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera aktive, apo i deklaruar në procedura të shpallura fituese.*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- **Kontratë pune të vlefshme** (organike ose angazhimi specifik për këtë projekt).
- **Licencë profesionale individuale** në fuqi për Mbikëqyrje të punimeve të zbatimit në ndërtim.
- **Certifikatë/Dëshmi kualifikimi** të vlefshme për Përgjegjësin e Sigurisë dhe Ekspertin e Ndhmës së Parë.
- **Diplomën universitare** përkatëse.

- **Librezë pune** ose Historik i Sigurimeve nga E-Albania
- **Curriculum Vitae (CV)** të detajuar dhe të nënshkruar nga vetë anëtarë i stafit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca nr. 10). Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të renditur i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të mësipërme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe në parimin e eficiencës, cilësisë dhe sigurimit të ekzekutimit të kontratës [162/2020, 285/2021]. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin dhe personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- **Nevoja për kategoritë e licencave:** Bazohet në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar me VKM nr. 943, datë 28.12.2016 [759/2014, 943/2016]. Pasi është analizuar objekti i prokurimit (mbikëqyrje punimesh për investimet e OSSH sh.a.), këto kategori mbulojnë saktësisht specifikat e punimeve të zbatimit në ndërtim, inxhinierinë elektrike (kabina, linja TM/TU/TL, nënstacione), gjeodezinë/topografinë dhe menaxhimin mjedisor. Kjo garanton që stafi zotëron autoritetin dhe ekspertizën ligjore për të ndjekur kantiere të këtij kompleksiteti.
- **Nevoja për punonjësit e specializuar:** Bazohet në mënyrë imperative në Ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë". Duke qenë se kantiere të OSSH sh.a. paraqesin rrezikshmëri të lartë nga ndërhyrjet në tension elektrik (TDP/TDI) dhe rreze të tjera mekanike/fizike në terren, monitorimi i rreptë i masave të mbrojtjes dhe gatishmëria për ndihmë të parë (trajnuar nga Kryqi i Kuq apo institucione të licencuara) janë jetike për parandalimin e aksidenteve dhe mbrojtjen e jetës së punonjësve.
- **Përfshirja e kushtit si "Drejtnes Teknik" në licencën e shoqërisë:** Është vendosur posaçërisht për të shmangur barrierat artificiale dhe për të nxitur konkurrencën e lirë. Ky lehtësim u mundëson operatorëve ekonomikë të angazhojnë ekspertë të jashtëm ose të dedikuar posaçërisht për këtë projekt (përmes kontratave të angazhimit), duke mos i penalizuar apo kufizuar ata vetëm tek stafi i tyre fiks organik.

Përcaktimi i kushtit që stafi inxhinierik dhe i specializuar të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera aktive apo të deklaruar në procedura të tjera ku është shpallur fitues, argumentohet si më poshtë:

- **Garantimi i pranisë efektive në kantier:** Mbikëqyrja e punimeve në infrastrukturën kritike energjetike (Rikonstrukcion nënstacionesh 110 kV, kabina transformatorësh dhe

rrjete TM/TU) mbart rrezikshmëri të lartë teknike dhe kërkon monitorim ditor, prani fizike dhe verifikim të pandërprerë të proceseve të punës dhe librezave të masave. Angazhimi i dyfishtë apo i mbivendosur i të njëjtëve inxhinierë në projekte të tjera aktive do të sillte pamundësi fizike për të ushtruar funksionin e mbikëqyrësit, duke cenuar cilësinë e kontrollit.

- **Mënjanimi i 'stafit fiktiv':** Ky kusht ndalon praktikën spekulative të tregut ku operatorët ekonomikë konkurrojnë formalisht në disa procedura njëkohësisht me të njëjtët inxhinierë, duke bllokuar kapacitetet e tyre njerëzore. Kjo siguron që Autoriteti Kontraktor të ketë në dispozicion një ekip teknik plotësisht të dedikuar për këtë projekt në momentin e lidhjes së kontratës.
- **Përputhshmëria me Sigurinë në Punë:** Përgjegjësi i Sigurisë dhe Eksperti i Ndhmës së Parë duhet të jenë operacionalë dhe të disponueshëm në vendin e ndërhyrjes për të garantuar zbatimin e rregullave të mbrojtjes (Ligji nr. 10237/2010), gjë që bën të domosdoshëm parandalimin e angazhimeve të tjera aktive.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj procedure, duhet të disponojë një numër minimal fuqie punëtore prej **minimalisht 4 (katër) punonjësish** për secilin lot (ose shumatores së loteve) për të cilat konkurron. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (**Shtojca nr. 10**) për muajin e fundit të deklaruar përpara datës së dorëzimit të ofertave.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik i renditur i primi duhet të paraqesë:

- **Vërtetimin zyrtar të numrit të punonjësve** të lëshuar nga Administrata Tatimore (shkarkuar nga portali e-Albania me kod QR) për muajin e fundit të deklaruar;
- **Listëpagesën zyrtare të punonjësve** (Formati E-SIG 025 e-Albania) të deklaruar në organet tatimore për muajin e fundit përkatës, ku të pasqyrohen punonjësit organikë të shoqërisë (*shënim: për stafin e kërkuar në pikën 2.3.3 që janë të angazhuar me kontratë specifike projekti/konsulencë dhe jo organikë, marrëdhënia provohet vetëm përmes kontratës së tyre të angazhimit*).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 10. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të renditur i primi dorëzimin e dokumenteve provuese të mësipërme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: Në përputhje të plotë me strukturën e ekipit të kërkuar te pika 2.3.3, duke garantuar që operatori ekonomik disponon burimet njerëzore të mjaftueshme për të mbuluar funksionet kyçe të mbikëqyrjes në terren. Saktësimi që stafi inxhinierik mund të mbulohet edhe përmes kontratave të angazhimit/konsulence (dhe jo detyrimisht organikë në listëpagesë) bëhet për të respektuar parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, duke u dhënë mundësi studiove teknike të mobilizojnë ekspertë sipas specifikave të projektit pa u ngarkuar me kosto fikse paraprake operative.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatat e vlefshme të menaxhimit të cilësisë, të përshtatshme për objektin e shërbimit që prokurohet, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (ose ekuivalente);
- **ISO 14001:2015** – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor (ose ekuivalente);
- **ISO 45001:2018** – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (ose ekuivalente);

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Organizmi Kombëtar i Akreditimit (Drejtoria e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues (anëtarë të IAF - *International Accreditation Forum*), të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në përputhje të plotë me nenin 79 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, që rregullon standardet e sigurimit të cilësisë dhe të menaxhimit mjedisor. Duke qenë se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) administron infrastrukturën kritike dhe strategjike energjetike të vendit, shërbimi i mbikëqyrjes së këtyre investimeve mbart kompleksitet të lartë risku. Përcaktimi i këtyre 5 standardeve specifike argumentohet si më poshtë:

- **ISO 9001 dhe ISO 14001:** Garantojnë që operatori aplikon procese të audituara të kontrollit të cilësisë së dokumentacionit inxhinierik dhe zbutjes së ndikimit negativ mjedisor gjatë punimeve në kantiere urbane/rurale.
- **ISO 45001:** Është teknikisht imperativ pasi ndërhyrjet në rrjetet elektrike dhe nënstacione mbartin rrezikshmëri të lartë për jetën e punonjësve (rrezik elektro-mekanik), duke kërkuar një sistem rigoroz të menaxhimit të sigurisë.

Kushtëzimi i akreditimit nga **DA (Drejtoria e Akreditimit)** ose anëtarët e **IAF** bëhet në përputhje me Ligjin nr. 116/2014 'Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit', duke garantuar vlefshmërinë ligjore dhe ndërkombëtare të certifikatave.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në zbatim të neneve 4 (pika 38/b) dhe 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 41 (pika 1) të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor ka argumentuar specifikimet teknike të përfshira në Termat e Referencës si më poshtë:

- **Kërkesat e Performancës:** Kërkesat funksionale të shërbimit (ndjekja e punimeve në terren, verifikimi i librezave të masave, kontrolli i testeve janë përcaktuar me qëllim që OSSH sh.a. të përzgjedhë një mbikëqyrës që garanton cilësi maksimale zbatimi, eficiencë dhe minimizim të humbjeve teknike në rrjet, duke mbrojtur fondet publike nga punimet me defekte.
- **Standardet Teknike:** Kriteret dhe standardet inxhinierike të kërkuara bazohen në legjislacionin shqiptar të ndërtimit (Ligji nr. 8402/1998, i ndryshuar), Rregulloren e Sigurimit Teknik dhe standardet ndërkombëtare të energjisë IEC/EN "**ose ekuivalente të tyre**". Këto kërkesa janë neutrale dhe të hapura për tregun.
- **Garantimi i Garës:** Specifikimet përshkruajnë karakteristika funksionale performance dhe nuk përmbajnë asnjë referencë ndaj markave, patentave, prodhimeve specifike apo origjinës së pajisjeve, duke respektuar plotësisht parimin e mosdiskriminimit. Çdo normativë teknike e cituar në dokumentet e tenderit shoqërohet standardisht me fjalët "**ose ekuivalente**".